



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Monitorimi i investimeve kapitale të KOSTT dhe KEDS për vitin 2018

Prishtinë, 2019



Përmbajtja:

Permbajtja:.....	2
Lista e shkurtesave:.....	3
HYRJE.....	4
KRITERET PER PËRZGJEDHJEN E PROJEKTEVE.....	5
PORCEDURA E PROKURIMIT	6
KOSTT	6
KEDS	6
PROJEKTET E PËRZGJEDHURA PËR MONITORIM	7
DALLIMET E PLANIFIKIMIT ME REALIZIMIN	7
SHQYRTIMI I DOKUMENTACIONIT QE KA TE BEJE ME KUALITETIN E MATERIALIT (FAT & SAT).....	10
KONKLuzionET	11
REKOMANDIMET.....	11
Shtojce - FAT test KOSTT	12
Shtojca - SAT test KOSTT	14
Shtojca - FAT test KEDS	16
Shtojca - SAT test KEDS	17



Lista e shkurtesave:

OST – Operatori i Rrjetit të Transmetimit

OS – Operatori i Sistemit

OT– Operatori i Tregut

FAT – Factory Acceptance Test

SAT - Site Acceptance Test

GIS – Gas Insulated System

HIS – Hybrid Insulated System

TL - tensioni i lartë

TM - tensioni i mesëm

TU - tensioni i ultë

SLF – Spatial Load Forecast

PRR2 – Periudha e Dytë Rregullative

Siguria e furnizimit me energji elektrike dhe kualiteti i saj varen nga niveli i shpenzimeve operative dhe kapitale. Për këtë qëllim ZRRE gjatë periudhave rregullative lejon nivel të caktuar të investimeve kapitale duke u bazuar ne projektet e planifikuara. Për të parë se si janë implementuar projektet e tilla, ZRRE në kuadër të përgjegjësive dhe kompetencave të saj, bënë monitorimet e nevojshme. Në këtë kuadër me anë të vendimit VB_114_2018 të bordit të ZRRE-së është themeluar edhe grupi punues për monitorim e investimeve kapitale të të licencuarve KOSTT dhe KEDS.

Për realizimin e këtij procesi, grupi monitorues përmes komunikimeve me shkrim dhe të vizitave në teren është fokusuar në monitorimin e aspektit procedural, teknik dhe financiar. Metodologjia e përdorur për realizimin e këtij monitorimi është bërë duke përzgjedhur projektet sipas rastësisë e të cilat janë të natyrave të ndryshme. Për këtë qëllim grupi punues ka kërkuar nga të licencuarit dosjet e projekteve përkatëse.

Pas shqyrtimit dhe analizimit të projekteve të përzgjedhura, grupi monitorues ka nxjerr rezultate të cilat për nga natyra janë të matshme (kuantitative) dhe kualitative. Në përgjithësi mund të themi se pas analizimit të dosjeve dhe vizitave në teren, i licencuari KOSTT procesin procedural dhe teknik e ka kryer në pajtueshmëri me kërkesat e përgjithshme teknike dhe procedurale si dhe ka ofruar dëshmi për projektet e përzgjedhura, ndërsa i licencuari KEDS ka shpjeguar procesin teknik dhe procedural por nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme.



KRITERET PER PËRZGJEDHJEN E PROJEKTEVE

Për të parë nëse projektet e planifikuara nga KOSTT dhe KEDS janë të domosdoshme për t'u realizuar, grupi monitorues ka analizuar kriteret e aplikuara për përzgjedhjen e projekteve të tilla. Kriteret kryesore të aplikuara janë:

- Mbulimi i ngarkesës;
- Siguria e furnizimit;
- Kualiteti i furnizimit;
- Numri i konsumatorëve të ndikuar;
- Zvogëlimi i humbjeve; dhe
- Përkrahja e Burimeve të ripërtritshme;

Përveç kriterëve të sipërpërmendura, janë marr parasysh edhe kriteret ashtu siç përcaktohen në Rregullën për vlerësimin e investimeve kapitale.



PORCEDURA E PROKURIMIT

KOSTT

Pas evidentimit të nevojës për investimet përkatëse, të prezantuara edhe në planin zhvillimor dhe investiv, të licencuarit shpallin shprehjen e interesit për të bërë investimet e nevojshme. Sipas dokumentacionit të ofruar, vërehet se ky proces është kryer nga KOSTT në mënyrë transparente, si dhe është bërë edhe evaluimi sipas kriterëve të kërkuara gjatë shpalljes së interesit.

Për të parë nëse janë respektuar kriteret e prokurimit publik, grupi monitorues ka përzgjedhur dhe analizuar disa projekte duke u fokusuar në çështjet si në vijim:

- Shprehjen e interesit;
- Ofertat e pranuar;
- Mënyrën e ofertimit dhe hapjes së ofertave;
- Kriteret teknike dhe financiare të vlerësimit;

Për të elaboruar më tej këtë proces në vijim po e përshkruajmë procesin e përzgjedhjes së ofertuesit për projektet e përzgjedhura. Vetëm ofertuesit e kualifikuar janë ftuar në procesin e hapjes së ofertave. Në këtë proces numri i ofertuesve ishte dy, ABB AG dhe SIEMENS. Përfaqësuesit e ofertuesve të kualifikuar janë nënshkruar në listën e pjesëmarrësve për të dëshmuar prezencën e tyre në këtë proces. Në prani të tyre janë hapur ofertat dhe është shpallur poentimi i tyre. Oferta teknike vlerësohet 60% nga totali i poentimit, kurse oferta financiare vlerësohet 40%. Në bazë të këtyre kriterëve, KOSTT ka përzgjedhur ofertën më të favorshme teknike dhe financiare. Ofertuesi i përzgjedhur ishte kompania SIEMENS e cila përveç se kishte ofertën me të mire teknike kishte edhe poentimin më të lartë në vlerësimin financiar.

KEDS

Vërehet se ky proces ka mangësi në KEDS, dhe KEDS nuk ka dëshmi të mjaftueshme se si kryhet ky proces, por kryesisht ka përshkruar praktikatat që KEDS aplikon në procesin e prokurimit.

Procesi i ofertimit bëhet duke dërguar shprehje të interesit kompanive të cilat me të cilat KEDS ka pasur bashkëpunim dhe disa kompanive tjera. Grupi monitorues ka vërejtur se KEDS u ka dërguar më shumë se dy kompanive shprehjen e interesit së bashku me dokumentacionin për ofertim, por nuk ka publikuar shprehjen e interesit në web-faqen elektronike dhe në ndonjë nga gazetatat zyrtare, siç kërkohet me ligjin e prokurimit publik.

Nga KEDS nuk është ofruar ndonjë dëshmi se si është bërë procesi i evaluimit, por vetëm se është ofruar shpjegim i shkurtër lidhur me të. Ky proces do të duhej bërë duke respektuar procedurat e parapara në ligjin e prokurimit publik, siç është evidentimi i pjesëmarrësve në kuadër të procesit dhe më pastaj përzgjedhja e fituesit bazuar në kriteret teknike dhe ekonomike të definuara paraprakisht.



PROJEKTET E PËRZGJEDHURA PËR MONITORIM

Projektet e përzgjedhura janë bërë sipas rastësisë të cilat janë të kategorive të ndryshme. Projektet e përzgjedhura të KOSTT-it janë:

- Re -vitalizimi i Nënstacioneve;
- Projektet e përforsimit (shtimi i autotransformatorëve); dhe
- Linjat transmetuese.

Projektet e përzgjedhura të KEDS janë:

- Projektet e Master Planit (përforsimet e rrjetit 10kV);
- Projektet e ndërlidhura me ngarkesën; dhe
- Projektet e përforsimit të rrjetit.

Për secilën nga kategoritë e projekteve është analizuar dokumentacioni teknik dhe janë bërë vizita në teren. Për të gjitha kategoritë e përmendura më sipër është përzgjedhur të paktën një projekt.

DALLIMET E PLANIFIKIMIT ME REALIZIMIN

Për të parë dallimet praktike në implementimin e projektit krahas planifikimit (projektimit), grupi punues ka kërkuar projektin e zbatimit dhe projektin e implementimit (AS-BUILD). Rëndësia e kësaj kërkesë bazohet në atë se gjatë implementimit mund të paraqiten ndryshime, efekti i të cilave mund të rezultojë në vonesa në implementim, ndikimin në kosto dhe ndikime tjera. Ndryshimet e mundshme duhet të argumentohen nga palët, duke siguruar dëshmitë teknike dhe financiare të tyre për të cilat nevojitet aprovim paraprak.

Në rastin e projekteve të përzgjedhura të KOSTT është konfirmuar dhe vërtetuar nga grupi punues se nuk ka dallime të tilla. Kur ka dallime të tilla, ato duhet arsyetuar dhe aprovuar nga donatorët dhe ZRrE.

Të dhënat për investimet kapitale të realizuara nga KOSTT janë të paraqitura në tabelën 1. Duhet pasur parasysh se ka dallime ndërmjet vlerave financiare të paguara nga KOSTT për projekte dhe vlera financiare e komisionimit të tyre. Sipas raportit për pagesa për investime kapitale KOSTT ka realizuar rreth 82% të pagesave për projektet e vitit 2018 në raport me lejimet, ndërsa sipas vlerës së komisionit të aseteve ashtu siç mund të shihet në tabelën 1 vlera e investimeve të komisionuara në raport me lejimet është rreth 25%. Vlen të theksohet se ky dallim rrjedh nga mos komisionimi i projektit të NS Drenasi 220/10(20)kV i cili pritet të komisionohet në mesin e këtij viti.

Kostoja financiare për projektet e realizuara nga KOSTT është paraqitur në tabelën në vijim:



Lista e projekteve	Lejuar (€'000)	Realizuar (€'000)
Projektet OST		
NS 220/10(20) kV - Drenasi - GIS me linjat / kablloet transmetuese 220kV (EBRD) me shërbimet konsulente dhe shpronësimet	7,384	-
Revitalizimi i pajisjeve TL në NS Therandë - HIS (EBRD) me shërbimet konsulente	2,259	2,352
Shpronësim dhe servitut për projektet e kfw faza IVI dhe V KfW	600	38
Punimi i kyçeve në rrjet të qytetit të ujit dhe kanalizimit në NS Prizreni 1, NS Prizreni 2, NS Prizreni 3, NS Lipjani.	51	51
Furnizimi me pjesë rezervë për nënstacione.	153	60.8
Totali i OST	10,447	2,502
Projektet OS		
Përfshirja e nënstacioneve të reja në sistemin SCADA/EMS në QND dhe QEND.	119	34
Furnizim me harduer.	34	14
Renovimi i ndërtesave Komanduese në: - 1. NS Deçani, NS Lipjani, - 2. NS Burim, NS Viti, - 3. NS Prishtina 3, NS Prizreni 3, - 4. NS Gjakova 2, NS Besiana dhe - 5. NS Vitia, Gjakova 1.	68	21
Totali i OS	220	68
Projektet OT		
Totali i OT	-	-
Gjithsej	10,667	2,570

Tabela 1 – Kostoja e projekteve të komisionuara nga KOSTT gjatë vitit 2018

Nga këto dallime të gjetura nga monitorimi, Bordi i ZRRE-së mund të rekomandojë KOSTT-in, se në rastin e planifikimit të investimeve duhet të bëjë vlerësime më të sakta, ngase këto investime mbulohen përmes tarifave, dhe një planifikim i tillë nuk do të mund të jetë i pranueshëm nga ZRRE.

Për të parë dallimet ndërmjet projekteve të planifikuara dhe atyre të realizuara nga KEDS janë ofruar të dhënat që kanë të bëjnë me projektimin fillestar të projekteve të përzgjedhura. Nga të dhënat e analizuara vërehet se KEDS ka ofruar vetëm skemat e situacionit për projektet konkrete dhe jo projektin në tërësi.

Nga të dhënat e paraqitura në tabelën me poshtë shihet se KEDS ka realizuar rreth 74% të investimeve krahasuar me nivelin e lejuar në vitin 2018. Në tabelën në vijim janë paraqitur projektet e lejuara dhe të realizuara për vitin 2018.

Përshkrimi	Njësia	2018 Planifikuar	2018 Realizuar
Ferizaj 2018	€000	161.98	27.2
Gjakove 2018	€000	433.57	-
Gjilan 2018	€000	159.06	842.2
Mitrovice 2018	€000	280.63	830.0
Peja 2018	€000	468.01	952.0
Prishtine 2018	€000	373.38	1,033.8



Prizren 2018	€000	515.83	6.8
Kalimi ne nivelin 20 kV	€000	3,906.49	1,239.4
Investimet SLF (TR TM/TU)*	€000	2,229.60	-
Projektet e përforcimit të rrjetit	€000	6,998.90	12,765.3
Njehsorët indiriket	€000	292.50	1,211.9
Njehsorët gjysme-indiriket	€000	493.00	
Njehsorët e thjesht elektronik	€000	2,220.00	
Rrjeti i avancuar (Smart Grid)	€000	1,600.00	1,300.0
Rrjeti i avancuar faza 2 (Smart Grid)	€000	1,000.00	
Renovimi i ndërtesave, Trafostacioneve, depo, etj.	€000	1,000.00	170.8
Ndarës linjor me ndërprerës	€000	1,000.00	
Vetura	€000	1,660.00	15.2
Makineri e rëndë	€000	526.00	
IT	€000	2,540.00	752.6
Pajisje special për teren (Matëse, GPS, etj)	€000	144.00	
Pajisje për siguri dhe mbrojtje në punë	€000	280.00	
Toka*	€000	200.00	13.6
Gjithsej	€000	28,483	21,161

Tabela 2 – Kostoja e projekteve të realizuara nga KEDS gjatë vitit 2018

Nga lista e projekteve të realizuara vërehet se KEDS ka realizuar mbi 80% të linja e projekteve të zgjerimit dhe përforcimit të rrjetit në krahasim me planifikim, ndërsa të linja e kalimit të nivelit të tensionit 10kV në 20kV niveli i realizuar është vetëm 31% krahasuar me planifikimin, kështu dallime ka edhe të projektet tjera. Nga kjo analizë rrjedh se KEDS në rastin e planifikimit të investimeve duhet të bëjë vlerësime më të sakta, ngase këto investime mbulohen përmes tarifave, dhe një planifikim i tillë nuk do të mund të jetë i pranueshëm nga ZRRE. Sqarimet për dallimet e tilla në projektet e realizuara në krahasim me ato të planifikuara nuk janë ofruar nga KEDS.

Këto mangësi të sipërpërmendura që janë gjetur nga procesi i monitorimit duhet të përmirësohen sipas rekomandimeve të cilat do të ipen nga Bordi i ZRRE-së.



SHQYRTIMI I DOKUMENTACIONIT QË KA TË BËJË ME KUALITETIN E MATERIALIT (FAT & SAT)

Me qëllim të verifikimit të kualitetit të materialit, grupi punues ka kërkuar shqyrtimet e kualitetit të materialit për projektet e përzgjedhura. KOSTT ka dërguar këto shqyrtime, të cilat janë bërë nga prodhuesit (Factory Acceptance Test) dhe disa prej tyre edhe në teren (Site Acceptance Test). Pas implementimit të projekteve, komisioni profesional nga KOSTT ka bërë pranimin teknik, dhe ka dhënë vërejtje për përmirësime në raste të caktuara. Është vërtetuar se janë bërë përmirësimet e tilla sipas afateve dhe rekomandimeve të komisionit të KOSTT. (shih shtojcën 1 – ekzemplare të FAT dhe SAT).

Sa i përket dokumentacionit të ofruar nga KEDS lidhur me FAT, vërehet se është bërë testi i FAT për një sasi të konsiderueshme të transformatorëve por që nuk është sqaruar konkretisht se cilat janë për projektet konkrete, përveç kësaj KEDS ka ofruar edhe dokumentacion për disa stabilimente të cilat kanë FAT testet por gjithashtu nuk është sqaruar se cilat i korrespondojnë projekteve të përzgjedhura gjatë monitorimit. Pas kërkesës shtesë të bërë nga ekipi i monitorimit, KEDS ka dërguar me shumë vonesë (17 ditë më vonë) dokumentacionin për FAT. Nga analizimi i tij është parë se mungon dokumentacioni për projektin e Uglarës dhe mungojnë FAT testet për asetet e tjera të projekteve si shtylla, kablllo, etj. Nga dosja e parë e FAT testeve të ofruara nga KEDS shihet se gjatë shqyrtimeve kanë qenë prezent edhe përfaqësues nga KEDS, ndërsa nga dokumentacioni i më vonshëm i ofruar vërehet se ata nuk kanë qenë prezent gjatë shqyrtimeve të bëra nga prodhuesi.

Këto mangësi të sipërpërmendura që janë gjetur nga procesi i monitorimit duhet të përmirësohen sipas rekomandimeve të cilat do të ipen nga Bordi i ZRRE-së.

Ekzemplarë të FAT dhe SAT testeve KEDS janë dhënë në shtojcë:



KONKLUZIONET

Nga monitorimi i investimeve kapitale mund të konkludohet:

KOSTT:

- KOSTT ka kryer procesin e prokurimit dhe evaluimit në pajtueshmëri me ligjin e prokurimit publik;
- KOSTT ka ofruar dëshmitë e nevojshme për FAT dhe SAT;
- KOSTT ka bërë planifikim të përafërt të investimeve;
- KOSTT ka vonesa në implementimin e projekteve.

KEDS:

- KEDS ka mangësi në respektimin e procesit të prokurimit;
- KEDS nuk ka ofruar në tërësi dëshmitë relevante për FAT;
- KEDS kanë vonesa në implementimin e projekteve;
- Ka dallime të theksuara ndërmjet vlerës financiare të realizuar ndaj planifikimit.

REKOMANDIMET

Nga monitorimi i investimeve kapitale mund të rekomandohet:

KOSTT:

- Të respektohet plani dinamik i investimeve ashtu që të mos rrezikohet siguria e furnizimit;
- Të kryejë projektet ashtu siç janë aprovuar gjatë PRR2 si dhe për ndryshimet e projekteve të njoftojë ZRRE-në me kohë.

KEDS:

- Rekomandohet KEDS të zbatojë ligjin e prokurimi publik;
- Rekomandohet KEDS të sigurojë FAT testet (dhe testet tjera relevante) për projekte;
- Të zbatojë planin dinamik dhe vlerësimin financiar të paraparë sipas projekteve.



Shtojce - FAT test KOSTT

SIEMENS

Confirmation on Factory Acceptance Tests Circuit-Breaker *Bescheinigung der Abnahmeprüfung des Leistungsschalters*

Customer / Country <i>Kunde / Land</i>	:	KOSTT / KOSOVO
Project <i>Projekt</i>	:	Viti, Burimi, Kline, Lipjani SS

Selected technical data *Ausgewählte technische Daten*

Circuit-breaker type <i>Leistungsschaltertyp</i>	:	3AP1FI
Year of construction / Serial No. <i>Baujahr / Fabriknummer</i>	:	16 / 35143028a
Works-number <i>Werknummer</i>	:	37061997
Rated voltage <i>Bemessungsspannung</i>	:	123,0 kV
Rated frequency <i>Bemessungsfrequenz</i>	:	50 Hz
Rated current <i>Bemessungsstrom</i>	:	2000 A
Rated short-circuit breaking current <i>Bemessungs-Kurzschluss-Ausschaltstrom</i>	:	40,0 kA
Rated range of ambient temperature <i>Bemessungs-Umgebungstemperaturbereich</i>	:	-30 ... 55°C
Insulating gas <i>Isoliergas</i>	:	SF6
Nominal insulating gas-pressure (gauge) at 20°C <i>Isoliergas-Bemessungsüberdruck bei 20°C</i>	:	6,0 bar
Wiring diagram / index <i>Schaltplan / Index</i>	:	458-00125-684 /
Rated operating sequences <i>Bemessungsschaltfolgen</i>	:	O-0,3S-CO-3MIN-CO
Date of tests <i>Prüfdatum</i>	:	27.09.2016

1 General *Allgemeines*

Compliance with the current editions of the below mentioned specifications has been checked by routine testing in our test laboratory: IEC Publ. 62271-1, IEC Publ. 62271-100
Die Übereinstimmung mit den gültigen Ausgaben folgender Vorschriften ist durch die Stückprüfung in unserem Prüffeld festgestellt worden: IEC Publ. 62271-1, IEC Publ. 62271-100

Test pressures are declared as gauge pressures.
Druckwerte werden als Überdruckwerte angegeben.






Test lab. <i>Prüffeld</i>	EM HP AIS OPS B MF CB EN TF	Date <i>Datum</i>	27.09.2016	Test engineer <i>Prüfingenieur</i>
------------------------------	--------------------------------	----------------------	------------	---------------------------------------





Type Typ	3AP1FI	Serial-No. Fabr.Nr.	35143028a	Page Seite	2	of von	7
-------------	--------	------------------------	-----------	---------------	---	-----------	---

2 Participants *Teilnehmer*

Name <i>Name</i>		Company <i>Firma</i>
Ms. Bukurije Dauti		KOSTT
Ms. Zera Ymeri		KOSTT
Mr. Erwin Dastl		Siemens Wien
Ms. Ute Peter		SIEMENS Berlin
Mr. Hartmut Kurfeld		SIEMENS Berlin



COMMISSIONING OF DISCONNECTORS

1. DISCONNECTOR WITH EARTHING SWITCH (-Q1,-Q51)

SITE TEST REPORT FOR HV DISCONNECTING SWITCH WITH EARTHING SWITCH (-Q1,-Q51)			
Project:	Improvement of Transmission Network Sector Programme IV and V Lot 4, Substation SS Vitja		Contract No.:
Customer:	KOSTT Sh.a	Report No.:	
Plant identification:	=E01-(Q1,Q51)	BAY:	E01 OHL 1802 Gjilani 1
Drawings:			

1.	TECHNICAL DATA:			
1.1	Manufacturer:	ALSTOM	Type:	S2DAT
1.2	Type of Operation mechanism	CMM		
1.2	Serial Number	A 6 3 2 5 2		
1.3	Operation mechanism	Three pole	Overall dimension drawing:	
1.4	Rated Voltage:	123 kV	Rated Current:	2000 A
1.6	Rated Frequency:	50 Hz	Year of manufacture	2016

2.	CHECK:	Sign after test	Remarks or measured values
2.1	Dimensional check	✓ <i>[Signature]</i>	
2.2	Verification of verticality of installed insulators	✓ <i>[Signature]</i>	
2.3	Verification of correct installation of drive	✓ <i>[Signature]</i>	
2.4	Verification of correct installation of shafts and transmissions components	✓ <i>[Signature]</i>	
2.5	Verification of alignment and coupling of fixed and mobile contacts	✓ <i>[Signature]</i>	

3.	TEST OF OPERATION:	Sign after test	Remarks or measured values
3.1	Perform 5 manual operations and verify that the opening and closing movements are correct	✓ <i>[Signature]</i>	
3.2	Perform 5 motor operations and check that the end positions are correctly reached	✓ <i>[Signature]</i>	
3.3	Verify the correct signaling of the auxiliary contacts	✓ <i>[Signature]</i>	



[Handwritten signatures]



SIEMENS	For Customer KOSTT/Consulectra
Name/Signature: Seljana Nuredini <i>[Signature]</i> Enver Ahmeti <i>[Signature]</i>	Name/Signature: Rashid Krasniqi <i>[Signature]</i>
Date: 02/12/2016	Date: 02.12.2016






Shtojca - FAT test KEDS

Page No: 1 / 88		
	TÜRKAK TÜRK AKREDİTASYON KURUMU TURKISH ACCREDITATION AGENCY	
Has been accredited		
BEST TESTING LABORATORY		
BALIKESİR ELEKTROMEKANİK SANAYİ TESİSLERİ A.Ş. Ağır Sanayi Bölgesi 10040 Balıkesir / Türkiye		
Test Report		
		Test TS EN ISO/IEC 17025 AB-0305-T
		AB-0305-T
		68014-68100
		25.04.2015

Customer name/address: KEDS
Serial No : 68014-68040 , 68041-68085 , 68086-68100
Identity : 3 PHASE OIL TYPE TRANSFORMER
Rated Power : 400 , 1000 , 1250 kVA
Rated Voltage : 20-10 / 0.4 kV
Testing Standard : IEC 60076
Date of Test : 25.04.2015
Number of pages of the report: 88
Testing Laboratory : ASB Distribution Transformer Test Laboratory
Remarks : <i>Test results are found to comply with the relevant IEC standards and contract conditions.</i>

The Turkish Accreditation Agency (TURKAK) is signatory to the multilateral agreements of the European co-operation for the Accreditation (EA) and of the International Laboratory Accreditation (ILAC) for the Mutual recognition of test reports
The test and/or measurement results, the uncertainties (if applicable) with confidence probability and test methods are given on the following pages which are part of this report.

BEST

Seal	Date	Person in charge of test	Head of testing Laboratory
	25.04.2015	Göksel ÖNTAN 	Necip KARABULUT Y. 

Witnessed by

This report shall not be reproduced other than in full except with the permission of BEST Elektromekanik Sanayi Tesisleri. A.Ş. Testing Laboratory. Testing reports without signature and seal are not valid.

Form no : 307



Shtojca - SAT test KEDS



Kompania Kosovare për Distribim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.A
Kosovo Electricity Distribution and Supply Company J.S.C.

DIVIZIONI I SHPERNDARJES

DISTRIKTI Prishtine

KOMPANIA KOSOVARE PËR DISTRIBIM DHE FURNIZIM ME ENERGIJE ELEKTRIKE SH.A
KOSOVO ELECTRICITY DISTRIBUTION AND SUPPLY COMPANY J.S.C.
KOSOVSKO PREUZETA ZA DISTRIBUCIJU I SNABEVANJE ELEKTRON ENERGIJOM DD
KEDS - S.H.A.

RAPORT TEKNIK

Mbi pranimin intern

Nr. 3745 Dt. 18.04.2018
PRISHTINE/A 1

KONSUMATORI KEDS

OBJEKTI LOT-10

ADRESA Gjinovc -32000003 -Mushitisht 32000002

#		PO	JO
1	Rrjeti kabllorik dhe ajror 10kv është punuar nga kompanija -Eliteko Suhareke .	x	
2	Tensioni ku do të kyqet rrjeti ajror është 10KV	x	
3	Eshtë bërë ndërtimi i stabilimentit shperndares :4+2+1-10(20)kV	x	
4	Punimi i tokzimeve i shtyllave të betonit është bërë sipas projektit (Atestet e shtyllave janë dorzuarë)	x	
5	Punimi i Tokëzimit punues i stabilimentit (Atesti është dorzuarë)	x	
6	Vendosja e shtyllave të betonit 12m tensionit të mesëm sipas Projektit	x	
7	Rrjeti ajror 10kv është ndërtuar sipas projektit dhe rregullave teknike	x	
8	Rrjeti ajror 0.4 kV është ndërtuar sipas projektit dhe rregullave teknike	x	

VËREJTJE:



Komisioni konstaton se:

a plotësohen kushtet për energjizim të objektit:

po

b nuk plotësohen kushtet për energjizim të objektit:

jo

KOMISIONI :

Emri dhe mbiemri

Nënshkrimi

1 Sabri Graçevci, kryetar

2 Sherif Salihaj, anetar

3 Ibrahim Spahiu, anetar